



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 267/7 Prot

Tiranë, më 08.11.2022

V E N D I M

Nr.132, datë 08.11.2022

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vorë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vorë,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 49, datë 05.4.2022 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimin në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Vorë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vorë.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimin në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 267/1 prot., datë 05.04.2022, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr. 267/2 prot., datë 5.4.2022 *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Vorë”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 267/5 prot., datë 07.09.2022 *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vorë”*, duke i lënë 20 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Pas kësaj, me shkresën nr. 4997/1 prot., datë 28.9.2022 *“Dërgohet projektraporti i nënshkruar” (protokolluar në KMSHC me nr. 267/6, dt. 03.10.2022)*, institucioni ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vorë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Me qëllim realizimin në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, gjatë zhvillimit të procedurave

për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, njësia përgjegjëse e institucionit duhet të veprojë duke ndjekur këto orientime:

- ✓ Nisur nga numri i lartë i pozicioneve vakante në institucion, gjatë procesit të miratimit të planit të rekrutimit për vitin 2023, të merren masa për përfshirjen e tyre, në mënyrë të detajuar dhe me afate konkrete konkurrimi.
 - ✓ Njësia përgjegjëse, para se të fillojë procesin e konkurremeve për të plotësuar vendet vakante, të hartojë planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe t'ia dërgojë për miratim Kryetarit të Bashkisë. Në të ardhmen ky proces duhet të ketë përfunduar brenda muajit shkurt të çdo viti kalendarik
 - ✓ Në kushtet kur ka një numër të madh pozicionesh të lira (27 pozicione), pozicionet e nivelit ekzekutiv të klasifikohen sipas natyrës së pozicionit, në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe në grupet e administrimit të posaçëm. Për pozicionet “*Specialist*”, për të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta, konkurrimet të zhvillohen në grup pozicionesh, sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 8, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.
3. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore në Bashkinë Vorë, të administrojë diplomën e shkollës së lartë dhe listën e notave për nëpunësin ***** në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose të vërtetuara te noteri dhe të jenë pjesë e dosjes personale të nëpunësit.
 4. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Vorë, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për punonjësin ***** , pasi nuk plotëson kriterin arsimor për njehsimin e diplomës universitare të përfutuar jashtë vendit, sipas përcaktimit në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, për tu pranuar në shërbimin civil.
 5. Njësia përgjegjëse të ndërpresë marrëdhënien e punës në shërbimin civil për nëpunësin ***** (akti nr. 226 prot., datë 31.3.2021) në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Biznesit*” dhe, për nëpunësin ***** (akti nr. 208 prot., datë 30.3.2021) në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë dhe Sportit*”, pasi nuk plotësojnë kriterin arsimor - “*Master shkencor*” apo “*Master professional*”, i përfutuar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me

kohëzgjatje normale 2 vite akademike, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar. Këto akte, në bazë të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 109, pika “d”, ato vlerësohen si akte administrative të paligjshëm dhe për pasojë, bazuar në nenin 113, të këtij ligji, duhet të anulohen.

Në të njëjtën kohë duhet të fillojë procedura për plotësimin e këtyre pozicioneve, sipas rregullave të shërbimit civil, nëpërmjet procedurës së konkurrimit

6. Njësia e burimeve njerëzore të ndërmarrë hapat e kërkuar ligjorë, në përditësimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm, i cili është evidentuar në përmbajtjen e raportit.
7. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të drejtojë procesin për riformulimin e përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe të mbahen parasysh gjatë procesit të miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit, për të zbatuar detyrimin ligjor të respektimit të skemës së funksionimit të shërbimit civil, parashikuar në nenin 19, të ligjit për nëpunësin civil. Një kopje e përshkrimeve të punës, të depozitohet në arkivin e institucionit.

Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore t'i njoftojë të gjithë aktorët e procesit të hartimit të përshkrimeve të punës me vendimin e Komisionerit, pasi në përfundim të afatit të paralajmërimit, përgjegjësia do të jetë personale për nëpunësin që nuk ka zbatuar detyrat e përcaktuara në vendim.

8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
9. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Vorë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në

lidhje me zbatimin e këtij vendimi si dhe të dërgojë dokumentacionin që vërteton masat e marra për të rregulluar situatën e ligjshmërisë.

10. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Vorë, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme.
11. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha